



REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRISË - DESTINAATË E KOSOVËS

01 Nr. / Br. 214/19

Nr. i fq. / Br. si - 17

Data / Datim 27.06.2019

VUSHTRRI - MÇIERN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -V- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 30 MAJ 2019

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fitim Halili, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës. Gjithashtu njoftoi se Qerim Selimi ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e anëtarit të kuvendit, dhe tani janë duke u zhvilluar procedurat për zëvendësimin e tij në KQZ.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - paraqiti një rezymë të përgjithshme lidhur me zhvillimet më të rëndësishme për Komunën e Vushtrisë në pesë muajt e fund të vitit 2019. Në këtë kontekst vlerësoi se zhvillimi më i rëndësishëm jo vetëm tani, por edhe për të ardhmen në kuptimin afatgjatë është investimi i kompanisë franceze Aqua Energy që do të bëjë në malin e Çiçavicës për të ndërtuar dhe zhvilluar projektin Çiçavica wind farm, i cili është ndër projektet më kapitale investive private në qytetin e Vushtrisë dhe në gjithë Kosovën. Në bazë të memorandumit që komuna ka nënshkruar në prezencën e ambasadorit francez në Republikën e Kosovës, në territorin e Komunës së Vushtrisë do të investohen rreth 100 milionë euro, ku do të vendosen deri në 17 turbina për prodhimin e energjisë elektrike nga era dhe në këtë rast do të prodhohen afër 100 Mw/h energji elektrike. Kompania e cila do të merret me këtë investim ka filluar procesin e studimit të fizibilitetit dhe studimeve tjera ambientale që nga fillimi i viti 2018. Lidhur me këtë projekt të gjitha dokumentet që i janë ofruar komunës tregojnë që ky investim është i sigurt dhe nuk ka

ndikim negativ në ambient dhe se ky projekt do t'i sjellë zhvillim Komunës së Vushtrrisë por mbi të gjitha do t'i sjellë zhvillim tërë Kosovës. Sot në Kosovë përjashtojmë Komunën e Kamenicës nuk prodhohet energji me erë dhe ky do të jetë një nga projektet më të mëdha për prodhimin e energjisë nga era. Në bazë të memorandumit që është nënshkruar, Komuna e Vushtrrisë do të përfitojë një pagesë direkte nga kompania e që është në vlerën prej 1 % të qarkullimit vjetor të kompanisë e që sipas kalkulimeve aktuale i bie që komuna do të përfitojë rreth 130,000.00 € në vit. Përveç kësaj komuna do të përfitojë po ashtu bursa për studentët tanë përmes ambasadës dhe Ministrisë së Arsimit të Francës në fushën e energjisë së ripërtëritshme dhe energjisë elektrike. Gjithashtu kjo kompani do të mbështesë sektorin e OJQ-ve në territorin e Komunës së Vushtrrisë për zhvillimin e turizmit energjetik në zonën e Çiçavicës dhe kompania po ashtu do të merr përsipër ndërtimin e infrastrukturës rrugore në atë pjesë si mirëmbajtjen e vazhdueshme të infrastrukturës rrugore në atë zonë. Ky investim është më i madhi në historinë e Vushtrrisë dhe të krejt regjionit, por ky investim do të kërkojë kohën e tij, por sipas parametrave aktuale mendohet që deri në vitin 2022 i tërë investimi të kompletohet ashtu që "Çiçavica wind farm" të jetë tërësisht funksionale dhe operacionale. Në vazhdim ai njoftoi se kompania Aqua Energy është lidere në fushën e energjisë së ripërtëritshme dhe se kjo kompani ka disa projekte në vendet e rajonit tonë në fushën e energjisë së erës. Lidhur me këtë projekt komuna ka qenë tërësisht transparente si me kompaninë ashtu edhe me kuvendin, por edhe me qytetarët e Komunës së Vushtrrisë dhe se ky projekt do të karakterizohet në çdo fazë me transparencë dhe përgjegjësi të plotë. Pra Vushtria e Çiçavica në veçanti do të merr një pamje tjetër dhe ky projekt do të jetë garant i një zhvillimi të mirëfilltë të komunës sonë. Një investim i tillë është tepër i mirëseardhur dhe do të ketë impakt pozitiv në zhvillimin e komunës, por edhe në ngritjen e kapaciteteve kadrovike në fushën e energjisë së ripërtëritshme. Në këtë kuadër ai tutje njoftoi se USAID-i amerikan e ka shpallur Komunën e Vushtrrisë ndër komunat më të mira në fushën e prokurimit publik, transparencë dhe qeverisje efektive për vitin 2018 dhe komunat tjera janë 10 pikë më poshtë se sa komuna jonë dhe për këtë ai falënderoi stafin e drejtorive komunale që janë angazhuar në projektin e USAID-it, dhe mendon se Komuna Vushtrrisë do të jetë shembull edhe për komunat tjera në fushën e prokurimit publik. Lidhur me këtë, USAID-i e ka shpërblyer komunën tonë duke bërë renovimin e zyrave të prokurimit, dhe më datë 6 qershor do të bëhet inaugurimi i këtyre zyrave ku prezent do të jetë edhe ambasadori amerikan i akredituar në Republikën e Kosovës. Komuna e Vushtrrisë ka shënuar përparim edhe në raportin e performancës, ku në vitin 2017 kemi qenë në pozitën 17, kurse në vitin 2018 jemi renditur në vendin e 6-të. Po ashtu KDI, ka vlerësuar lartë komunën tonë në fushën e transparencës, llogaridhënës dhe qeverisjes së mirë dhe kjo është shumë pozitive sepse shoqëria civile po jep vlerësim të lartë sa i përket transparencës dhe shpenzimit të parasë publike. Në fund njoftoi se komuna gjendet në fazën finale në projektin për kyçjet individuale në rrjetin e ujësjellësit ku për këtë kërkoi bashkëpunimin e kryetarëve të fshatrave, këshillit dhe asamblistëve.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - ngriti shqetësimin e banorëve të rajonit të Artakollit lidhur me rrugën R220 e cila është shtruar në asfalt para 2 apo 3 muaj dhe tani ajo ka filluar të dëmtohet duke u hapur gropa, për këtë ajo ceku se bëhet fjalë për kualitet të dobët të ndërtimit të kësaj rruge. Lidhur me këtë ajo kërkoi nga komuna, që këtë problem ta adresojë në ministrinë gjegjëse ashtu që të evitohen këto probleme.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – pasi e përgëzoi kryetarin e komunës, për projektin për investime në Çiçavicë, pyeti se a janë bërë përlllogaritjet se sa Mw/h shpenzon komuna jonë, dhe se ndërtimi i kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme a do t'i plotësojë nevojat e energjisë për Komunën e Vushtrrisë. Pastaj pyeti kryetarin e komunës se në kuadër të memorandumit të mirëkuptimit lidhur me rrugën "Dalip Maloku" a do të ketë vetëm mirëmbajtje dhe meremetim të

kësaj rruge aty ku ka prishje, apo do të ketë edhe investime tjera siç është ndriçimi publik dhe vendosja e kanalizimit pasi është një gjendje e rëndë sa i përket ujërave të zeza.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se në kuadër të projektit për energji të ripërtëritshme do të prodhohen 100 MWh energji elektrike, dhe kjo shkon përtej shpenzimeve që ka Komuna e Vushtrrisë, por kjo energji do të shkarkohet në rrjetin e Kosovës, pastaj do të përdoret në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Tutje vlerësoi se me realizimin e këtij projekti Vushtrria bëhet qyteti me shkallën më të lartë të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme në rajonin e Ballkanit. Në këtë kuadër ai shprehu keqardhje se disa komuna të përfshira në këtë proces zyrtarisht kanë dal kundër këtij investimi, dhe këtë e kanë bërë duke u deklaruar me shkrim. Pastaj ai falënderoi kuvendin për mbështetjen e dhënë në aprovimin e memorandumit të mirëkuptimit i lidhur mes Komunës së Vushtrrisë Prishtinës, Podujevës dhe Obiliqit për rrugën Stanoc-Breznicë-Kozaricë Lupç, ku ideja e memorandumit është që rruga “Dalip Maloku” të bëhet rrugë regjionale me qëllim që të kemi një mirëmbajtje sa më të mirë. Në këtë kuadër do të investohet në rregullimin e kanalizimit, ndriçimin publik dhe trotuarin dhe pastaj kjo rrugë të futet në mbikëqyrjen e Ministrisë së Infrastrukturës.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit - tha se kryetari i komunës e ka një “cilësi të jashtëzakonshme” dhe ajo cilësi është “për t’iu qitur hi syve të tjerëve”, kjo për faktin se nuk e di askush se për çfarë investimi milionësh bëhet falë pasi që komuna jonë ka nënshkruar vetëm një memorandum mirëkuptimi të thjeshtë. Andaj lidhur me këtë pyeti a i është dërguar Komunës së Vushtrrisë ndonjë analizë që Çiçavica është e gatshme dhe plotëson të gjitha kushtet atmosferike për mullinjtë e erës për energji të ripërtëritshme, kjo për arsyen bindëse sepse një kompani bullgare, ka tri vite që bënë analiza lidhur me energjinë e erës dhe vetëm pas gjashtë muajve pret të dalë një raport vlerësues lidhur me këtë projekt, për t’u kuptuar se Çiçavica është e gatshme për të pranuar ata mullinjtë të erës. Pastaj ai në cilësinë e një kundërshtari politik i sugjeroi kryetarit të komunës që t’i ketë më shumë në prioritet qytetarët e komunës sesa ambasadorët e akredituar në Republikën e Kosovës. Tutje vlerësoi se kryetari i komunës banon në Prishtinë dhe nuk i bashkëndjenë sfidat dhe problemet e qytetarit të Vushtrrisë, si ato të mungesës së ujit të pijshëm dhe të ndaljes së energjisë elektrike.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se të gjitha studimet për projektin e Çiçavicës janë bërë nga kompani të licencuara dhe këto i janë prezantuar komunës. Këto studime përfshijnë vendosjen e analizatorëve që janë vendosur qysh në vitin 2017, pastaj është bërë studimi i ndikimit në mjedis, studimi i ndikimit në zogj dhe lakuriqë dhe se të gjitha këto studime i janë prezantuar Komunës së Vushtrrisë në prezencë të ambasadorit amerikan. Tutje vlerësoi se një kompani e cila është lidere në botë për çështjet e investimeve në energjinë e ripërtëritshme, nuk hyn në një projekt gjigand milionësh pa pasur apriori një studim të saktë lidhur me sigurinë e projektit. Në këtë kontekst vlerësoi se i ngjall lumturi fakti se pasi të kompletohet ky projekt do të shihen fluturake në Çiçavicë duke prodhuar energji nga era, kjo është qenësore, ndërsa nuk ka fare rëndësi se a do të jetë ai kryetar i komunës pas disa viteve apo do të jetë dikush tjetër. Mandej ai apeloj tek grupi kuvendar i PDK-së që të ndikojnë tek partia e tyre që mos të pengojnë këtë projekt pasi që Komuna e Drenasit zyrtarisht është shprehur kundër këtij projekti. Në fund lidhur me performancën e komunës ceku se nëse dikush e konteston vlerësimin e USAID-it, atëherë vështirë t’i besohet dikujt, për këtë ceku se do të jetë sfiduese mbajta e të njëjtit ritëm të performancës komunale përmdryshe është shumë i kënaqur me zhvillimet pozitive që janë duke ndodhur. Në fund apeloj tek të gjithë që ta përkrahin projektin “Çiçavica wind farm” pa dallime politike pasi që ai është në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se askush nuk është kundër projektit për Çiçavicën dhe ceku se do të ishte tepër i lumtur nëse ky projekt do të realizohej. Tutje shtoi se në vitin 2010 një kompani zvicerane ka nxjerrë një studim që shpejtësia e erës në Kosovë për mbi 6 metra për sekondë arrin vetëm në Budakovë, Kamenicë dhe Golesh, lidhur me këtë shpreson që kjo kompani ta ketë gabim ashtu që Komuna e Vushtrrisë të ketë fatin që të investohet në projektin 100 milionësh.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – njoftoi se shkalla e shpenzimit të energjisë elektrike në Vushtri gjatë mëngjesit arrin në 14 Mw, ndërsa gjatë stinës së dimrit maksimalja e shpenzimit arrin në 28 Mw. Pastaj sqaroi se disa fshatra të komunës sonë nuk janë të lidhura me trafostacionin e Komunës së Vushtrrisë siç kanë: fshati Stanoc i Poshtëm, Prelluzhë, Bivolak, Gllavatin, Zhilivodë, Stroc, Beçuk dhe Mihaliq, të cilat furnizohen me energji elektrike nga trafostacioni i Obiliqit. Gjithashtu ai informoi se edhe në rajonin e Shalës së Bajgorës janë bërë studime për zhvillimin e kapaciteteve të energjisë me erë dhe kjo është një sukses për komunën tonë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – e përgëzoi kryetarin e komunës për projektin për energji nga era, duke shpresuar se ky projekt do të realizohet në një të ardhme të afërt, i cili do të jetë dobiprurës për komunën dhe qytetarët e Vushtrrisë. Tutje shtoi se marrëveshja për grumbullimin e mbeturinave nga kompania “Uniteti” ka skaduar më 31.12.2019, dhe ajo është vazhduar për 3 muaj nga muaji janar 2019 e cila është nënshkruar nga menaxheri i kompanisë “Uniteti” njësia në Vushtri. Pastaj shtoi se më datë 2 ose 3 prill pas një takimi me kryeshefin ekzekutiv të kësaj kompanie, kryetari i komunës kishte deklaruar se nuk ka marrëveshje me unitetin për grumbullimin e mbeturinave, kurse në të njëjtën kohë është nënshkruar marrëveshja më datë 29 mars dhe nuk dihet se si është vendosur prapa numri i protokollit të kësaj marrëveshjeje, kjo i bie se kompanisë “Uniteti” është duke iu bërë presion dhe shantazh me anë të këtyre marrëveshjeve tremujore. Aktualisht ka indikacione se kryeshefi ekzekutiv e ka suspenduar nga pozita menaxherin e njësisë së Kompanisë “Uniteti” njësia në Vushtri, ndërsa ky i fundit është duke e keqpërdorur automatikisht e komunës në kundërshtim me ligjin dhe autorizimin e dhënë nga kryetari i komunës. Lidhur me këtë dhe menaxhimin e mbeturinave duhet të thirret një mbledhje e veçantë dhe për qytetarët e Vushtrrisë duhet të jep raport kryeshefi ekzekutiv i kësaj kompanie.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se nëse për diçka duhet të krenohemi, atëherë është menaxhimi jashtëzakonisht i mirë i mbeturinave gjatë vitit 2018, por edhe tash në vitin 2019 dhe kjo po bëhet falë angazhimit të lartë të strukturave komunale dhe kompanisë “Unitetit” njësia e Vushtrrisë. Kjo njësi nuk ka pasur asnjë borxh gjatë vitit 2018 dhe 2019, dhe shtoi se komuna nuk e pagueu borxhin e komunave tjera sepse kjo është e përcaktuar edhe me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ku secili i bartë përgjegjësitë për aksionet dhe obligimet e veta, e në këtë rast edhe njësia në Vushtri e kompanisë “Uniteti” i bartë vetëm përgjegjësitë për obligimet e veta. Edhe në të kaluarën, por edhe tani komuna gjithëherë i ka nënshkruar kontratat me menaxherin e njësisë në Vushtri, kjo për faktin se KRPP-ja, ka dhënë përgjigje me shkrim se për kontrata inhouse, të cilat i njeh Ligji i Prokurimit lejohet shmangia e procedurave të tenderimit për kontratat që nënshkruhen me njësinë e Kompanisë në të cilën komuna është aksionare. Pastaj vlerësoi se nga eksponentë të caktuar nga pushteti i kaluar ka pasur intencë për ta kontrolluar tenderin për grumbullimin e mbeturinave dhe për këtë kishte pasur edhe përgatitje paraprake. Mandej ai përsëriti se gjithëherë ai ka nënshkruar marrëveshjet me menaxherin e njësisë së “Unitetit” në Vushtri, dhe u zotua se derisa ai do të jetë në pozitën e kryetarit të komunës, kurrë nuk do të lejojë që paratë e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrugëve në komunat tjera siç ishte rasti me Komunën e Mitrovicës. Tutje deklaroi se Komuna e Vushtrrisë tani është ndër komunat më të pastra dhe për këtë është shpërblyer edhe me çmim nga

mekanizma të jashtëm, tani secilës ekonomi familjare një herë në javë i barten mbeturinat dhe tani mund të thuhet se kemi avancim të mirë në procesin e mbrojtjes ambientale të komunës sonë. Për të gjitha këto suksese të gjithë duhet të jemi të lumtur, dhe vlerësoi se dikush e që po shihet edhe nga kuvendi ka intenca për ta shkatërruar kompaninë “Uniteti”, por këtë nuk do ta lejojmë në asnjë formë. Në fund tha se njësia e kompanisë “Uniteti” në Vushtrri, ka pasur suksese më të mëdha gjatë vitit 2018, por edhe këtë vit dhe kjo është reflektuar edhe në ekzekutimin e pagave të punëtorëve, në përmirësimin e mjedisit në Vushtrrisë, ka pasur përmirësim edhe në ndarjen e mbeturinave në burime, dhe këto suksese dikë po e pengojnë, andaj për këtë ka ndodhur suspendimi i menaxherit të njësise tonë, por këto forma konspirative dhe shantazhiste nuk do të lejohen kurrë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se menaxhimi i procesit të mbeturinave në komunën tonë ka qenë sfidues edhe në të kaluarën por edhe tani dhe është tentuar të gjendet një zgjidhje adekuate për këtë problematikë. Tutje shtoi se kompania “Uniteti” funksionon në bazë të statutit të saj, dhe dihet mirëfilli se nënshkrimi i kontratës nga ana e menaxherit të kësaj njësie është bërë në mënyrë të kundërligjshme, për faktin se menaxheri i njësise së kompanisë në fjalë, nuk ka të drejtë të nënshkruaj pa pasur autorizimin e kryeshefit ekzekutiv të kompanisë “Uniteti”. Pastaj deklaroi se ai posedon një ekzemplar të asaj kontrate e cila nuk mban fare vulën e kompanisë për faktin se nuk është personi i autorizuar që ka nënshkruar atë kontratë, andaj kësaj del në pah se është shkelur ligji. Nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale kushdo që dëshiron pa i përfillur kriteret ligjore dhe kjo ka ndodhur në rastin konkret gjë e cila do të shkaktojë dilema edhe sa i përket ligjshmërisë së pagesave që janë shkaktuar më vonë. Kompania regjionale “Uniteti” në të cilën jemi aksionarë edhe ne si komunë, nuk i jep kurrfarë autorizimi kryetarëve të të tri komunave që janë aksionare të kompanisë, për të emëruar dhe shkarkuar drejtorët e njësive gjegjëse, as të përzgjedhë me kënd të nënshkruajë marrëveshje. Kryeshefi ekzekutiv i ka kompetencat që i burojnë nga ligji e të cilat mund t’i delegojë, por në rastin konkret nuk ka pasur autorizim për nënshkrim dhe kjo është kontratë e paligjshme gjë e cila është konfirmuar edhe nga ana e vet bordit të drejtorëve të vet kompanisë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se në bazë të reagimeve që i sheh në kuvend nga anëtarët e PDK-së ka përshtypjen se krejt PDK-ja është e angazhuar që ta dëmtojë kompaninë “Uniteti”, por për këtë bëri thirrje që të mos ketë ndërhyrje në këtë kompani, por t’i lënë njerëzit që ta kryejnë punën e tyre. Pastaj vlerësoi se ndoshta dikush mund të ketë inate politike nga e kaluara që nuk kanë shkuar si duhet punët, por ftoj që të lihen anash inatet dhe të punohet për të mirën e përgjithshme. Mandej ai përsëriti se nënshkrimi i kontratës nuk paraqet shkelje ligjore, pasi që është vepruar konform rekomandimit të KRPP-së, dhe kjo është plotësisht ligjore pasi që nga fillimi marrëdhëniet kontraktuese ishin akorduar mes kryetarit të komunës dhe shefit të “Unitetit” njësia në Vushtrri. Andaj lidhur me të gjitha këto ftoi grupin kuvendar të PDK-së që të bashkohet në punë të mira dhe suksese për të qar proceset përpara, t’i gëzohen të arriturve në “Unitet” dhe mos të bëhen pengesë për ndërtimin e kësaj kompanie dhe mbrojtjen e interesit të përgjithshëm.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – përsëriti se kryetari i komunës ka drojën e ligjit për shkeljet tjera që i ka bërë, dhe tek kompania “Uniteti”, sepse ai e di se kur e ka nënshkruar atë kontratë nuk ka pasur autorizim sepse i njëjti ishte tërhequr nga kryeshefi ekzekutiv, mandej në këtë kontratë kishte pasur ndryshim në datë dhe numër të protokollit gjë që lë dyshime akoma më shumë për falsifikim dhe gjëra të kundërligjshme në këtë aspekt. Mandej shtoi se është indikative që nëse pagesat janë nga kjo kontratë dhe janë ekzekutuar do të ketë aq më shumë probleme ligjore dhe shkelje. Ai i apeloj kryetarit të komunës që mos të merret me grupin e PDK-së, por të merret me punët e komunës dhe të qytetarëve. Pastaj u zotua para qytetarëve se grupi i tij politik nuk

interferon në kompaninë “Uniteti”, por do të luftojë deri në fund për t’i mbrojtur interesat e punëtorëve dhe interesat e qytetarëve. Në fund e përmbylli se nëse dikush ka deklaruar “se nuk keni parë gjë akoma” lidhur me shkeljet dhe keqpërdorimet, atëherë ai deklaroi se tash e tutje do t’i shihni të gjitha.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - përsëriti se procesi i auditimit sapo ka përfunduar dhe ndër të tjera janë audituar edhe kontratat me kompaninë “Uniteti”, po përgjigjja e këtij institucioni është sa nuk ka pasur asnjë shkelje ligjore sa i përket këtyre që pretendohet sot në kuvend. Prandaj kompania në fjalë nuk ka pasur asnjë dëm sa i përket nënshkrimit të këtyre kontratave, por përkundrazi kompania ka përfituar. Tutje shtoi se ai është i gatshëm që të ballafaqohet dhe fton organet kompetente që ta bëjnë punën e tyre në kontrollin e plotë të çdo shkelje eventuale. Në këtë kontekst ai njoftoi se deri më tani ai i ka dërguar në prokurori pesë lëndë që lidhen me pushtetin e kaluar e që kanë të bëjnë me projektet më të mëdha për Komunën e Vushtrrisë, por me këtë nuk dëshiron të bëjë politikë, por e lë që organet e drejtësisë ta bëjnë punën e tyre. Nëse në këto raste ka keqpërdorim, atëherë secili le t’i bartë pasojat e veta, dhe për këto ai fton që mos të bëhet politikë, por nëse edhe aktualisht dikush nga qeveria e tij ka bërë shkelje të ligjit atëherë ai është i gatshëm të japë përgjegjësi konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit – tha se nuk dëshiron të bëhet “avokat i askujt” duke shtuar se për lëndët të cilat kryetari i komunës deklaroi se i ka dërguar në prokurori, ai e inkurajon që të vazhdojë që ato t’i procedojë të gjitha për të cilat ekzistojnë dyshime. Pastaj shtoi se ai si përfaqësuese i opozitës ka të drejtë të hedh pretendime për ato që dyshohet se ka keqpërdorime apo nënshkrim të kontratave të dëmshme dhe të qëllimshme nga ana e kryetarit të komunës. Më tutje vlerësoi se kryetari i komunës nuk mund ta luaj *<gardianin moral>* as atij dhe askujt tjetër. Emërimi i shefit të kompanisë “Uniteti” dihet se është bërë jashtëligjshëm, për faktin se ai person ka pasur pozicione politike me çka kjo i ndalohet me ligj. Lidhur me punët e kryera në kompaninë “Uniteti” vlerësoi se sukseset e arritura janë falë punës dhe djersës së pakursyer të punëtorëve, sepse kryetari i komunës nuk është shpëtimtari i madh dhe i pavlerësuar i Komunës së Vushtrrisë, sepse veprat dhe ndryshimet e qytetit janë meritë e punës së pakursyer të punëtorëve tanë. Në kontekst të kësaj ceku se fatkeqësisht punës për qytetarët ia ka zënë vendin “fotografia”, ndërsa përgjegjësisë qytetare dhe impenjimit ia ka zënë vendin plaçka dhe haraçi, kjo dëshmohet me faktin se vëllai i kryetarit të komunës brenda ditës viziton objektin e komunës me nga 10 herë. Kurse lidhur me lëndët të cilat kryetari i komunës i ka dërguar në prokurori, kërkoi që të vazhdojë t’i dërgojë të gjitha ato për të cilat ka dyshime, sepse siç ai deklaroi nuk ka faj kryetari i komunës, por partia e tij sepse kryetarit të komunës duhet t’i bëhet gjyqi publik për të bëmat e tij dhe kur flet për gjyqin publik mendon argumentimin me fakte dhe denoncimin e kryetarit të komunës për keqpërdorimet megalomane që janë duke u bërë në Komunën e Vushtrrisë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – i tërhoqi vërejtjen kryetarit të komunës për siç tha që kryetari i komunës disa herë ka përsëritur duke u deklaruar se sa të jetë ai kryetar nuk do të ndërrohet destinimi i fabrikës “Llamkos”, nuk do të hap procedurat për pronën ndërtimore për banesat kolektive dhe deklarimi i sotshëm, andaj pyeti se a duhet edhe kryetari i komunës të jetë i përgjegjshëm në respektimin e ligjit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - në përgjigjen e tij ndaj anëtarëve të kuvendit u zotua se gjithëherë do ta respektojë ligjin edhe në pozitën e kryetarit të komunës e edhe si person privat. Pastaj në kundërpërgjigje ndaj anëtarit të kuvendit z. Maxhuni vlerësoi se i vjen shumë keq që një anëtar i kuvendit përdor kësi lloj gjuhe të urrejtjes me gjyq publik sepse gjyqi publik nënkupton kërcënim direkt për kryetarin e komunës dhe qeverinë e tij. Pastaj shtoi se si parti politike janë mësuar me gjyqe publike, dhe me ekzekutime politike, nga të tjerët, por i sugjeroi anëtarit të

kuvendit z.Maxhuni që të ketë kujdes në zgjedhjen e fjalëve pasi që ai është i ri dhe nuk e kupton se çfarë në fakt i bie që dikujt t'i bësh gjyq publik, sepse gjyqi publik është kërcënim direkt dhe për më shumë kërcënim ndaj një kryetari komune. Tutje shtoi se kjo thirrje është e rrezikshme sepse kjo i bie që të tjerët që nuk pajtohen me mendimin e tyre politike të dalin e ta sulmojnë kryetarin e komunës dhe drejtorët e tij, mandej ai e respekton mendimin ndryshe të 13 mijë qytetarëve që kanë votuar kundër tij dhe koalicionit të qeverisë aktuale, por është e papranueshme gjuha e përdorur që këta qytetarë të nxiten për sulm atak ndaj kryetarit të komunës. Prandaj si rrjedhojë e këtyre ai ftoi grupin kuvendar të PDK-së që të deklarohet publikisht kundër gjuhës që nxitë dhunë politike ndaj zyrtarëve publik me anë të gjyqeve publike, dhe kërkoi që krerët e PDK-së të dalin e të kërkojnë nga qytetarët që mos të përdorin apo të mendojë për përdorim të dhunës, të heqin dorë nga kërcënimi dhe shantazhi ndaj kryetarit të komunës. Në fund kërkoi nga anëtari i kuvendit z.Maxhuni që të kërkojë falje publike për gjuhën e përdorur të dhunës, si dhe nga kuvendi i komunës që të dalë dhe ta aprovojë një deklaratë kundër gjuhës politike që nxitë dhunë ndaj zyrtarëve publik.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit – sqaroi se kur përdori termin gjyq publik, kishte aluduar në argumentimin me faktet dhe denoncimin e kryetarit të komunës dhe të kujtdo qoftë për keqpërdorime që bëhen duke shpërdoruar pozitën zyrtare. Pastaj vazhdoi duke cilësuar se është e vërtetë që Vushtrria nuk i pranon disa gjëra, Vushtrria nuk e pranon një kryetar komune uzurpator, për faktin se me sa ai di familja e kryetarit të komunës jeton në pronë publike, andaj kërkoi nga Drejtori i Kadastrit që të sjellë numrin e ngastrës për ta evidentuar se në cilën pronë banon familja e kryetarit të komunës dhe për t'u konstatuar e vërteta se a është kryetari i komunës uzurpator i pronës publike.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të PDK-së njoftoi se diskutimi i anëtarit të kuvendit z.Maxhuni nuk paraqet nxitje dhe gjuhë të dhunës politike, dhe deklaroi se nuk tërhiqen nga diskutimi i tij.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit – kërkoi nga të gjitha partitë politike në kuvend që të përmbahen nga gjuha e urrejtjes politike dhe retorika e panevojshme, kërkoi gjithashtu që të procedohet me rendin e ditës dhe me debate konstruktive.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – kërkoi nga anëtari i kuvendit z.Maxhuni që të kërkojë falje publike për gjuhën e cila nxitë dhunë politike, sepse kjo lloj gjuhe është e papranueshme, mandej shtoi se janë të gatshëm që të bëjnë krahasime për punën e drejtorive komunale, por jo në këtë formë duke shantazhuar zyrtarët publik komunal.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – apeloj për gjuhë të bashkëpunimit dhe pajtimit politik, duke mos akuzuar pa fakte dhe pa argumente, nëse ka fakte është mirë që ato të adresohen në organet zyrtare kompetente të drejtësisë. Mandej shtoi se kur komuna ka sukses atëherë është mirë t'i gëzohemi të gjithë se ai sukses na përket të gjithëve d.m.th të gjitha partive politike.

Hamdi Ferizi - qytetar - ngriti shqetësimin e tij për një zonë kadastrale në fshatin Banjskë te tabela numër 15 ku kishte një konflikt të vazhdueshëm me një fqinj të tij. Tutje tha se kishte bërë disa herë kërkesa në Drejtorinë e Kadastrit, mirëpo asnjëherë nuk i është kthyer asnjë përgjigje. Ai tregoi se ka qenë në Ministrinë e Bujqësisë, por ata e kanë drejtuar në Drejtorinë e Kadastrit.

Adnan Lahu, drejtor DGJKP-së - pasi e falënderoi qytetarin për ngritjen e këtij shqetësimi ai tregoi se kanë pasur deri më tani disa takime me banorët e zonës kadastrale me nr. 15, mirëpo nuk kanë arritur pajtimin e dëshiruar. Problem edhe më i madh bëhet edhe fakti se shumë dokumente janë marrë nga shteti serb gjatë luftës dhe kjo u ka sjellë shumë probleme. Ai i ftoi prapë në takim kurdo që ata janë të gatshëm për të arritur një marrëveshje.

Hamdi Ferizi, qytetar – theksoi se është e vështirë të arrihet marrëveshje kur pala tjetër në këtë rast nuk dëshiron një gjë të tillë, por kërkoi nga drejtoria që kjo e fundit të shkojë dhe t’ua përcaktojë pikat në këtë pjesë dhe t’ua definojë kufijtë e tokës së tyre.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - e sugjeroi qytetarin që të drejtohet në Agjencinë Kadastrale të Kosovës pasi që ajo parcelë është në komosacion.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit – hapi diskutim për rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se ky kuvend ka pasur edhe më herët deklarata kundër dhunës dhe nuk jemi kundër tyre, mirëpo nuk e shohim të udhës futjen e një pike të tillë në mënyrë kaq të shpejtë pa u konsultuar fare me KPF-në, kurse kërkoi që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - theksoi se do të sjellët deklarata e printuar dhe do ta kenë mundësinë secili ta lexojë para se ta votojë dhe sqaroi se kanë të drejtë të sjellin në kuvend pika kur të gjithë dakordohen për një gjë të tillë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – kërkoi ndryshim-plotësimin e Rregullores për dhënien e dekoratave. Këtë e kërkoi nën arsyetimin që në Ditën e çlirimit më 17 qershor të ndahen dy çmime “Nderi i qytetit”.

Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 23 vota “për” 2 vota “kundër” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 25 prill 2019;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i rezolutës, kundër gjuhës politike që nxitë dhunë politike ndaj zyrtarëve publik komunal;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me qarkoren buxhetore për vitin 2020;
5. Shqyrtimi i Draft-planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Gllavatin;
8. Shqyrtimi i Draft-planit komunal të veprimit për eficiency të energjisë 2019-2021 (shqyrtimi i dytë);
9. Njoftimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lidhur me rrugën “Bajram Bozhllani”
10. Të ndryshme.
 - a). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 25 prill 2019

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25.4.2019.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i rezolutës, kundër gjuhës politike që nxitë dhunë politike ndaj zyrtarëve publik komunal

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - deklaroi se janë kundër dhunës dhe përkrahim çdo rezolutë, por kjo e ofruar sot në këtë formë u sjellë pa asnjë diskutim të mëhershëm dhe e shohim si një akrobacion politik të kryetarit. Në këtë deklaratë, pika 2 të hiqet nga teksti fjalia gjyqe publike të zyrtarëve komunal. Nëse pranohet ky propozim i tyre do ta përkrahim një rezolutë të tillë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - theksoi se inatet politike po ndikojnë shumë keq nga të dy taborët si ai i pozitës po ashtu edhe ai i opozitës po vepronë vetëm me inate politike. Njëherazi e përmendi një rast kur kryetari i komunës e ka quajtur fëmijë asamblistin Lorik Maxhuni se ky ka reaguar duke i treguar kryetarit se ka vepruar shumë keq. Edhe sot po i them Lorik Maxhunit se ka vepruar shumë keq me atë fjali të tij edhe pse shpreson dhe beson se nuk e ka pasur atë qëllim. Kërkoj nga Lorik Maxhuni të kërkojë falje njësoj sikur kishte kërkuar falje kryetari për atë fjalën fëmijaq.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - theksoi se është hera e tretë ose e katërt që asamblistët vihen në pozita të palakueshme nga ana e kryetarit të komunës. Fjalën që e foli Loriku askush nuk e thotë se është e mirë, mirëpo pasi që e sqaroi se nuk e ka pasur në atë kontekst nuk e shoh të arsyeshme të këtë deklaratë. Kërkoj nga kryetari që ta tërheq këtë deklaratë pas sqarimit nga ana e anëtarit të kuvendit z. Lorik Maxhuni.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – sqaroi arsyen e ngritjes së kësaj rezolute duke marrë shembull një vrasje të pa luftës të një gazetari si pasojë e deklaratave të pamatura të asaj kohe. Gjyqi publik është thirrje për dhunë publike dhe kërkoj nga PDK-ja si subjekt serioz politik të tërhiqet nga deklaratimet e tilla që nxisin dhunë. Unë për një fjalë që e kam thënë kam kërkuar falje për çdo kënd që është ndier i ofenduar. Gjyqi publik është linçim dhe thirrje për dhunë ndaj zyrtarëve publik komunal. Sot nuk më ka kërcënuar vetëm mua po edhe katër drejtorët e LDK-së.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit - pasi që i përshëndeti të gjithë qytetarët që po e dëgjojnë në radio “Vicianum” theksoi se të gjithë ata që mendojnë se ka folur diçka për të cilën nuk është i vetëdijshëm ata kanë gabuar. Unë jetoj me të vërtetat e mia që mundohem çdo ditë t’i kthjellojë tha ndër të tjera zt. Maxhuni në fjalën e tij. Ai jeton në një qytet të vogël, por me njerëz me zemër të madhe dhe sfidën e ballafaqimit të jetesës së përditshme dhe me shijen dhe ndjenjën se pushteti aktual i Komunës i Vushtrisë po bëhet çdo ditë e më shumë kriminal. Ndër të tjera tregoi se ka kërkuar në fillim të kësaj qeverisjeje nga zt. Hysni Gërguri që të distancohet pasi që kjo qeverisje nuk është e Lidhjes Demokratike. Ai tha për kryetarin e komunës se është një gënjeshtar shumë i madh ku më së shumti i gënjen bashkëpunëtorët e tij. Ai përmendi edhe familjen e kryetarit ku tha se jeton në pronë publike dhe përmendi edhe vëllain e kryetarit që e quajti me epitelin “Salih tenderi” për shkak të bëmave të tij, andaj kërkoj nga kryetari i komunës që të sqarojë se cili është pozicioni i vëllait të tij në Komunën e Vushtrisë apo ai sillet nëpër objektin e komunës për t’i shantazhuar drejtorët dhe zyrtarët komunal. Në fund përmbylli fjalën e tij duke thënë se të gabosh është njerëzore, por të mashtrosh është djallëzore.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit - tha se pas dy seancave që kam bërë betimin nuk po shoh se po bëhet ndonjë punë ose diskutim i frytshëm në interes të qytetarëve të Komunës së Vushtrisë, mirëpo vetëm politikë ku edhe ftoi për një unitet më të madh.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - kërkoj nga kryetari ta tërheq këtë propozim, nëse nuk e tërheq nuk mund të shndërrohet nga rezoluta në deklaratë, pasi kuvendi e ka votuar si të tillë për futje në rend të ditës.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - kërkoj të rivotohet edhe njëherë dhe të votohet nga rezoluta në deklaratë. Ai theksoi se deklarata e deputetit në fjalë ishte deklaratë linçuese e cila nxitë dhunë

të hapur publike dhe ishte deklaratë shumë e rëndë. Kërkojmë që kjo deklaratë të mos ndërrohet asnjë pikë nga ajo që është shkruar.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - kërkoi që kjo rezolutë të mbetet e tillë dhe të mos shndërrohet në deklaratë ku theksoi se kjo është rezoluta e parë e miratuar nga ky kuvend pasi që praktikë ka qenë më herët të miratohen vetëm deklaratata.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - propozoi që fjalia gjyqë publike të futet në thonjëza.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - kërkoi nga grupi parlamentar i PDK-së që të kërkojë falje në emër të Lorik Maxhunit.

Ilmi Azemi anëtar i kuvendit - vlerësoi se nuk kanë nevojë të kërkojnë falje për arsye se u sqarua deklaratata e zt.Maxhuni në kontekstin pse ka thënë atë fjalë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 24 vota “për” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2019, duke marrë për bazë deklaratimet në kuvendin e komunës, për gjyqë publike ndaj zyrtarëve publik, me qëllim të ruajtjes së harmonisë politike, etnike e fetare, miraton këtë:

REZOLUTË

1. **Harmonia politike e ndërfitare dhe etnike në qytetin më të vjetër të Kosovës në Vushtrri është vlera më themelore qytetare që e kemi trashëgim e që duhet ta kultivojmë e ta ruajmë.**
 2. **Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë distancohet nga gjuha politike e subjekteve apo individëve që përmes deklaratimeve publike bëjnë thirrje për dhunë politike e gjyqë publike të zyrtarëve publik komunal.**
 3. **Gjuha, e cila nxitë dhunën politike apo çfarëdo lloj mosdurimi politik fetar e etnik është e papranueshme për Kuvendin e Komunës dhe për qytetin e Vushtrrisë.**
 4. **Cilido pretendim për keqpërdorim të pozitës zyrtare apo të autoritetit duhet të adresohet në organet kompetente ligjvënëse.**
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me qarkoren buxhetore për vitin 2020

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - tha se buxheti i komunës krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje nga granti i përgjithshëm prej 11.76 % dhe ajo që më bëri përshtypje është ulja e të hyrave vetanake. Pyetja e tij është në rritjen e buxhetit për shëndetësi dhe arsim a është bërë për arsye të rritjes se pagave?

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit – kërkoi të bëhet një ndërrim vendesh për dëgjime buxhetore mes saj dhe Ymer Haradinaj.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së – paraqiti sqarime lidhur me qarkoren buxhetore për vitin 2020, dhe hartimin e kornizës afatmesme buxhetore ku do të inkorporohen të gjitha projektet dhe do të përcaktohen pagat (sqaroi se kjo rritje i mbulon pagat me rritje).

5. Shqyrtimi i Draft-planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Plani Komunal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2019-2021.

2. Diskutimi publik fillon nga data 12 qershor 2019 dhe zgjat deri më 12 korrik 2019.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim e Komunës së Vushtrrisë që si propozues i draft-planit në fjalë, të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyra e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-planit në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin korrik 2019.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - kërkoi sqarim për figurat që janë propozuar për dekorata.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - propozoi që kuvendi ta shmang propozim-ndryshimin për Draft-rregulloren për dhënien e dekoratave me numër të protokollit 88/15, përkatësisht nenin 2 të kësaj rregulloreje. Me qëllimin më të mirë kërkoi që titulli <nderi i qytetit> t’i ndahet krahas shumë të respektuarit Ali Januzit edhe Idriz Asllanit, si shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për veprën e tyre.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - deklaroi se me zemër e thotë se do të ishte i kënaqur që t’i jepej ky titull Idriz Asllanit së bashku me mua gjë e cila do të më qetësonte. Kërkoi që komisioni t’na sjellë nga një biografi për secilin të propozuar.

Bahrije Ademi - Murati, anëtare e kuvendit - ajo e vlerëson lart modestinë e bacës Ali, por kërkon që mos të shkelet rregullorja e komunës që ky çmim të ndahet për dy persona në të njëjtën kohë. Propozoi që Idriz Asllani të propozohet për vitin e ardhshëm.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit - nëse nuk ka shkelje, kërkoj që edhe Baca Idriz të jetë së bashku me bacën Ali.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - me gjithë respektin për Idriz Asllanin, por nuk jemi të pajtimit që ky çmim të ndahet në dy pjesë. Jemi të pajtimit që baca Idriz të jetë i propozuar për vitin e ardhshëm dhe mos ta shkelim rregulloren që ky çmim të ndahet në dy pjesë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se nuk ka kërkuar shkelje, por shmangien e rregullores. Mandej vlerësoi se dhënia e çmimit dy personave nuk bie ndesh me asnjë ligj duke filluar nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, dhe ligjet tjera. Sa i përket akteve nënligjore siç është rregullorja, ajo është aprovuar nga ana e kuvendit dhe e njëjta mund të ndryshohet, shmanget dhe shfuqizohet.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - tha se nuk e nderojmë askënd me ndarjen e këtij çmimi, kurse kërkoj që të dakordohen për vitin e ardhshëm që çmimi <nderi i qytetit> t'i ndahet Idriz Asllanit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se në vitin 2014 ky çmim iu ka nda 4 personave nga ky kuvend, pasi që është viti jubilar i çlirimit mundemi deri në 5 çmime për <nderin e qytetit>, prapë mendoj se do të ishte nder për qytetin po ta ndanim këtë çmim.

Ali Januzi anëtar i kuvendit - po të shpallej edhe Idrizi së bashku me mua do të më bënte mirë edhe mua do të më qetësonte.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - kam dëgjuar se vitin e kaluar se baca Ali është tërheq dhe kërkoj mos ta vendosim në kësi pozita të pavolitshme dy personalitete qysh janë Ali Januzi dhe Idriz Asllani.

Fatoni Shabani, anëtar i kuvendit - vlerësoi se askush nuk mund t'na luaj rolin e profesorit dhe t'na i mësoj rregulloret dhe shtoi se Nezir Klinaku nuk ka mundësi ta përçajë askënd pasi ky është qëllimi i tij. Po ashtu potencoi se rregullorja nuk lejon ta ndajmë këtë çmim për dy persona.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se titulli nderi i qytetit jepet që fëmijët tanë ta kenë dikë si shembull të mirë për t'i ndjekur gjurmët e tij dhe nuk jepet për inate të askujt dhe këto dy figura që u propozuan të dyja e meritojnë këtë çmim.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit - njoftoi se Idriz Aallani pasi e ka dëgjuar këtë diskutim tërhiqet për këtë vit nga kandidatura për çmimin <nderi i qytetit>.

Pas diskutimeve, kuvendi me vota unanime aprovoi propozimi-vendimin për ndarjen e çmimit "Nderi i qytetit":

1. Me këtë vendim, Ali Januzit nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi "Nderi i qytetit", për kontributin e dhënë si veprimtar i çështjes kombëtare, pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981, si dhe për kontributin e çmuar në luftën për çlirimin e Kosovës.

2. Dorëzimi i këtij çmimi do të bëhet nga Kryetari i Komunës më datë 17 qershor- "Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - i falënderoi të gjitha subjektet politike në kuvend për këtë titull. Jeta dhe vepra ime janë për qytetin tim Vushtrrinë dhe i jam mirënjohës të gjithëve edhe njëherë.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë pas votimit me 29 vota "për" aprovoi propozim-vendimin për ndarjen e çmimit "Pena e artë":

1. Me këtë vendim, Remzije Zekollit nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi "Pena e artë", për kontributin e dhënë si autore e disa librave në fushën e letërsisë, publicistikës dhe kritikës letrare.

2. Dorëzimi i këtij çmimi do të bëhet nga Kryetari i komunës më datë 17 qershor – "Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Fatmire Cecelia, drejtoreshë e DKRS-së - paraqiti sqarime para kuvendit, lidhur me propozim-vendimin për dekorata, ku ndër të tjera njoftoi për emrat e propozuar për mirënjohje dhe vlerësoi se të gjitha propozimet janë të arsyetuara mirë dhe të njëjtat mund të aprovohen.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se propozimet kanë ardhur edhe nga shoqatat që operojnë në komunën tonë dhe komisioni ka bërë një punë të pavarur dhe të pandikuar.

Melihate Basholli – Latifi, anëtare e kuvendit - kërkoi nga kryetari që kur të formojë komisione të ketë parasysh kuotën gjinore dhe tha se kjo është listë burrash dhe për herët tjera të kenë parasysh në propozim edhe emrat e femrave që kanë kontribuar.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - propozoi për vitet tjera t'i kenë parasysh emrat e Abdullah Vojvodës dhe Agim Bregajt për kontributin në luftë, por edhe për doktorëshën Mejreme Ismajli e cila ka dhënë një kontribut të çmuar në ofrimin e ndihmës shëndetësore gjatë periudhës së luftës.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit - tha se shtëpisë së doktor Abdullah Vojvodës, duhet t'i vendoset një pllakë me një mbishkrim ku do të evidentohet se kjo shtëpi gjatë kohës së luftës ka shërbyer si spital, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, Kuvendi i komunës për nder të "Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë", më 17 qershor ndan këto mirënjohje:

1.1 Shefqet Karakashi (post mortum) – për kontributin e dhënë në fushën e arsimit;

1.2 Dr. Sc. Jusuf S. Vatoci - veteran i arsimit, për kontributin e dhënë në shkencë;

1.3 Avni Semir Imeri - për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së (veteran i luftës);

1.4 Ramë Hysen Gashi - (post-mortum) - ish i burgosur politik, veprimtar i çështjes kombëtare;

1.5 Isa Behram Sherifi - për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së (invalid i luftës);

1.6 Hamdi Pronaj - për kontributin e dhënë gjatë viteve të 90-ta në fushën e arsimit;

1.7 Valdet Uka - për kontributin e dhënë në lëmin e shëndetësisë;

1.8 Qenan Çerkezi - për kontributin e dhënë në artizanat;

1.9 Ilmi Hysni Saraçi - për kontributin e tij në tri luftëra në trojet shqiptare, ku në luftën e Kosovës ishte plagosur;

1.10 Xhafer Haradinaj - për kontributin e dhënë në lëmin e bujqësisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtoritë tjera kompetentet komunale.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Gllavatin

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së sqaroi se te kjo parcelë tashmë ekzistojnë varreza, por kërkesa e banorëve të fshatit Gllototinit është të zgjerohet kjo hapësirë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - kërkoi që në këtë kuadër përpos përkufizimit të kufijve të kësaj parcele me destinim varreza, duhet të bëhet edhe rritja e sipërfaqes ashtu që banorët e atij lokaliteti të kenë mundësi të bëjnë rrethimin e atyre varrezave.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi as votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për varrezat e fshatit Gllavatin në pjesë të parcelës kadastrale P-70202017-00565-0, në sipërfaqe prej 7200m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 102233m² dhe pjesë e parcelës kadastrale P-70202017-00563-0 në sipërfaqe prej 500m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2856m², Zona Kadastrale Gllavatin, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Draft-planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë 2019-2021 (shqyrtimit i dytë)

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se është shumë e nevojshme që koordinatori për efikasitet të energjisë t'i bashkërendojë veprimet me hartuesin e këtij plani, pasi që në plan ekzistojnë disa gabime në të dhëna, pasi që shumë objekte kanë dal me konsum shumë të vogël të energjisë e që është mirë që koordinatori t'i evitojë këto lëshime para se ky plan të bëhet final.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet **Plani Komunal i Veprimit për Efikasitet të Energjisë 2019-2021.**

2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave të përgjithshme në zvogëlimin e konsumit të energjisë, rritja e nivelit të rahatisë dhe uljen e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin e Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin "Plani i Veprimit për Efikasitet të Energjisë 2019-2021 i Komunës së Vushtrrisë për vitet 2019-2021".

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Njoftimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lidhur me rrugën "Bajram Bozhani"

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit - tha se nuk e sheh të udhës ardhjen e kësaj çështjeje përsëri në kuvend pasi me vendimin Nr.250/15 të vitit 2015 është bërë shkurtrimi i një segmenti të rrugës me emrin "Bajram Bozhani", pas një kërkesë që kemi pasur nga familja e

Mursel Feratit e parashtruar në vitin 2014. Ai vlerësoi se një ndarje e tillë e kësaj rruge është shumë e arsyeshme pasi që i përfill kërkesat e të dy palëve dhe kërkon nga kuvendi që peticioni në fjalë të refuzohet dhe të mbeten në fuqi vendimet e mëhershme të kuvendit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – kërkoj që drejtorja ta sjellë para kuvendit vendimin për shkurtimin e rrugës “Bajram Bozhilani”. Tutje shtoi se në vitin 2015 ishte votuar vendimi për ndryshimin e emërimit të rrugëve, sipas ankesave, duke mos e pasur listën para anëtarëve të kuvendit dhe këtu shtrohet dilema se shkurtimi i segmentit të kësaj rruge a ka qenë pjesë e listës që është aprovuar me vendimin e kuvendit të vitit 2015.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi, pas votimit me 21 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim refuzohet peticioni i qytetarëve që banojnë në rrugën “Bajram Bozhilani”, lidhur me kthimin e tabelës së rrugës, e cila ka qenë e vendosur më herët, si dhe mbetet në fuqi vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 250/15 i datës 30.11.2015 me të cilin është aprovuar ndryshimi dhe formimi i rrugës me emërtim të ri me emrin “Vëllezërit Ferati”, si segmenti i ri i rrugës “Bajram Bozhilani”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtorja për Shërbimeve Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë më datë 30 maj 2019 ka shqyrtuar peticionin e parashtruar nga përfaqësuesi i lagjes “Latifi”, z. Vesel Latifi, lidhur me kthimin e tabelës së rrugës “Bajram Bozhilani” e emërtuar në vitin 2013, në ç’rast ka refuzuar këtë peticion për arsye se emërtimi i një segmenti të kësaj rruge me emrin “Vëllezërit Ferati” në fshatin Sllatinë është bërë konform legjislacionit në fuqi, Ligjit për Sistemin e Adresave Nr.04/L-071, si dhe nenit 6, paragrafi 1.2.2.6. të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2012 për Krijimin dhe Administrimin e Listës Alfabetike për Emërtimin e Listës Rezervë dhe Vendosjen e tyre në Regjistrin Komunal të Adresave. Emërtimi i këtij segmenti të rrugës me emrin “Vëllezërit Ferati” është bërë në sajë të peticionit të banorëve të lagjeve “Ferati” dhe “Uka” të fshatit Sllatinë, i cili është parashtruar më datë 5.11.2014, në ç’rast Kuvendi i Komunës me vendimin e tij me numër protokollit 250/15 të datës 30.11.2015 pas propozimit të Komisionit komunal për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, ka aprovuar listën për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë, ku në kuadër të asaj liste është i inkorporuar ndryshimi i këtij segmenti me emrin “Vëllezërit Ferati”.


Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Të ndryshme:

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – në emrin e të gjithëve qytetarëve të Komunës së Vushtrisë ua uroi Bajramin e Madh të gjithëve besimtarëve të besimit islam, duke iu dëshiruar shëndet, gëzime dhe mbarësi në familjet e tyre.


Mbledhja përfundoi në ora 14:20.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

